

Prof. Dr. Aurela Anastas

Anëtare e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Tiranë, më 25 Tetor 2022

**SKUADRAT PRO BONO PËR MBËSHTETJEN E SHTRESAVE NË
NEVOJË KANË NEVOJË TË SHTOHEN DHE TË FORCOHEN**

*Fjala e mbajtur me rastin e dorëzimit të Certifikatës së Mirënjohjes nga
Universiteti Evropian i Tiranës*

I nderuar Z. Selami Xhepa,

Rektor i Universitetit Evropian të Tiranës,

E nderuar Znj. Juela Lamçe,

Dekane e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve
Ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar studentë,

Duke shprehur falënderimet e mia të përzemërta për këtë certifikatë mirënjohjeje, mirënjohje të cilën e këmbej ndaj jush me shumë dashuri, doja të vlerësoja me dy fjalë rëndësinë e çështjes për të cilën më dedikohet ajo: *“Për kontributin e çmuar në shoqërinë civile, përmes promovimit të skuadrave “pro bono”, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, posaçërisht të grave”*.

Krijimi i skuadrave *pro bono* në Shqipëri, është një nismë e organizatave të shoqërisë civile që fillimisht, u përket viteve 2006-2007, e cila u bazua në përvojën e skuadrave të studentëve “pro bono” në universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo nismë, u aplikua për herë të parë nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, por shumë shpejt njohu një përhapje të gjerë edhe në universitete të tjera të vendit. Skuadrat “pro bono” krijohen tashmë çdo vit për të mbështetur me ndihmë ligjore falas shtresat në nevojë përmes vullnetarizmit të studentëve të Drejtësisë, të cilët kanë përfutur njohuri juridike përgjatë viteve të para të studimit të tyre në universitet.

Në vitin 2007, unë isha drejtuese e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe në bashkëpunim me avokaten e kësaj qendre, Znj. Aurela Bozo, filluam punën për ngritjen e skuadrës së parë pro bono, me mbështetjen e programeve të USAID-it dhe

të Ambasadës së SHBA-së. Kjo ide u formësua më mirë pas kualifikimeve tona në ShBA. Përpos njohurive që përfuam atje, disa rrethana ndikuan që kjo ide të zhvillohej dhe të materializohej. Nga kualifikimet në SHBA ne gjetëm materialin e parë të trajnimit të skuadrave *pro bono*, të cilin e përkthyem. Ky material shërbeu si literaturë për përgatitjen e skuadrave, pasi aty përshkruhej organizimi dhe procedura e veprimtarisë së tyre. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që na nxiti për të ndërmarrë këtë nismë, ishte edhe pjesëmarrja aktive e QNL-së në hartimin dhe zbatimin e ligjit “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i cili hyri në fuqi më 1 Qershor të vitit 2007.

Ndërkohë, në Qendrën tonë ofronim ndihmë ligjore falas për gratë dhe vajzat dhe konstatuam se kishim shumë nevojë për burime njerëzore, veçanërisht për avokatë. Me projekte ishte e pamundur që të siguronim avokatë për të gjitha rastet që paraqiteshin. Në këto kushte skuadrat e para *pro bono* që ne krijuam dhe trajnuam na erdhën në ndihmë. Organizuam punën e tyre në grupe të vogla prej 2 ose tre studentësh, të cilët siguronin këshillime ligjore dhe asistencë ndaj personave në nevojë në Qendër dhe në gjykatë. Studentët, të mbikëqyrur nga avokatet e QNL-së, Znj. Besa Saraci dhe Znj. Iris Aliaj u aftësuan të kryenin informimin e klientëve për legjislacionin, këshillimin e tyre në lidhje me konfliktet që kishin, hartimin e dokumentacionit dhe akteve të ndryshme me shkrim, si dhe shoqërimin e tyre në gjykatë. Avokatja kujdesej për menaxhimin e rastit dhe përfaqësimin në gjykatë, duke u mbështetur edhe në ndihmën e studentëve të skuadrave *pro bono*.

Kështu, nga viti 2008 e në vijim, ne krijuam skuadra të reja “*pro bono*” me pjesëmarrjen e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë të universiteteve të ndryshme, publike e private. Ato ripërtëriheshin çdo vit, përmes trajnimit të studentëve të rinj. Gjatë procesit, provuam të kishim skuadra mikse, ku studentëve të drejtësisë iu bashkoheshin edhe psikologë si dhe studentë të shkencave sociale, të cilat u vunë në veprim. Megjithatë, përvoja jonë tregoi se është më mirë që secila fushë të krijojë skuadra të veçanta, që mund të bashkohen në trajnime me njohuri ndërdisiplinore dhe veprimtari të përbashkëta.

Si e shoh unë perspektivën e skuadrave “*pro bono*”?

Unë mendoj se veprimtaria e tyre jo vetëm duhet të vijojë, por duhet të përhapet dhe forcohet. Rëndësia e tyre është rritur mjaft në kuadrin e zbatimit të ligjit nr. 111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, si dhe të zbatimit të strategjisë së Kuvendit të Shqipërisë për edukimin ligjor të publikut 2018-2022. Çdo fakultet Drejtësie në vend, ka shumë burime për të ofruar ndihmën ligjore falas. Në radhë të

parë, këto skuadra janë shumë të dobishme për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Unë shpresoj dhe uroj që këto skuadra të përhapen në të gjitha fakultetet e Drejtësisë në vend dhe të shërbejnë për zbatimin e këtyre akteve si dhe të ligjeve të tjera, veçanërisht ato për mbrojtjen e shtresave në nevojë.

Përmes punës në skuadra *pro bono* studentët bëhen një pikë e fortë e ofrimit të ndihmës juridike parësore sipas ligjit. Gjithashtu, këto skuadra ndihmojnë edhe në edukimin ligjor të shtetasve, në informimin e qytetarëve në lidhje me të drejtat dhe gëzimin e tyre. Për këtë është e rëndësishme që puna të organizohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, me të cilat universitetet mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi.

Nga ana tjetër, këto skuadra ndihmojnë në vetë përparimin e studentëve të drejtësisë dhe i aftësojnë ata për tregun e punës. Funksionimi i tyre është një mundësi e mirë që studentët të tregojnë aftësitë vullnetare dhe humanitare që kanë. Gjatë përvojës sonë, kemi konstatuar se këto skuadra janë një laborator për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve. Prandaj, është e rëndësishme për vendin dhe universitetet që këto skuadra të zhvillohen dhe të mirorganizohen, duke rritur cilësinë e anëtarëve të tyre nën kujdesin e pedagogëve-avokatë. Kjo përbën një nga veprimtaritë më të rëndësishme shoqërore e mësimore të studentëve. Ndoshta me zhvillimin e tyre do të punojmë edhe për një status ligjor të anëtarit të skuadrës ‘*pro bono*’, me qëllim që puna e studentit *pro bono* të njihet e të vlerësohet kudo që të shkojë.

Më lejoni që me këtë rast të falënderoj të gjitha koleget e mia, avokatet e sipërpërmendura, me të cilët punuam për mirëfunksionimin e këtyre skuadrave, si dhe Znj. Arjana Fullani dhe Znj. Vjollca Meçaj, të cilat të mbështetura nga Shoqata e Grave Juriste krijuan dhe drejtuan Qendrën për ofrimin e ndihmës ligjore falas për gratë dhe vajzat në nevojë.

Edhe njëherë, juve faleminderit për këtë vlerësim shumë të çmuar për mua!

Kam besim se ky vlerësim do t’i shërbejë punës së skuadrave *pro bono*. Universiteti Evropian i Tiranës, si dhe universitetet e tjera të vendit do ta zhvillojnë më tej këtë nismë, duke i forcuar përvojat e krijuara deri tani në ofrimin e ndihmës ligjore falas nga studentët e drejtësisë.

Me respekt,

Prof. Dr. Aurela Anastas